



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 732/1 Prot.

Tiranë, më 07.05.2021

**V E N D I M**

**Nr. 74 , Datë 07 / 05 / 2021**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 29, datë 25.02.2021, të paraqitur nga I.B kundër Spitalit Rajonal Fier, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “përgjegjësisë prindërore<sup>1</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “*Që prej vitit 2014 është e punësuar si mjekë specialiste endokrinologe, pranë Spitalit Rajonal Fier. Për shkaqe shëndetësore bashkëshorti i saj ka ndërruar jetë në vitin 2014 dhe që nga ajo periudhë është përgjegjëse për dy fëmijët e saj të moshës 8 dhe 12 vjeç. Me Urdhrin nr. 83, datë 12.02.2021 të Drejtorit të Spitalit Fier “Për kryerjen e shërbimit të rojes 24 orësh në shërbimin e mjekësisë së përgjithshme” është njoftuar se në grafikun e rojeve në Shërbimin e Mjekësisë së Përgjithshme pranë spitalit, është caktuar zyrtarisht për të kryer mbulimin e shërbimit 24-orësh në Shërbimin e Mjekësisë së Përgjithshme në datë 24.02.2021, duke zëvendësuar një mjekë tjetër. Ankuesja informon se që nga viti 2014, kur bashkëshorti i ka ndërruar jetë, për shkak të kushteve familjare, pasi jeton e vetme në shtëpi me qira, prindërit e saj jetojnë në Berat dhe prindërit e bashkëshortit janë të moshuar dhe në gjendje të rënduar shëndetësore dhe psikologjike, pas humbjes së parakohshme të djalit të tyre, është kujdesur dhe ka ushtruar përgjegjësinë prindërore si prind i vetëm dhe si kryefamiljare ndaj të dy fëmijëve të mitur. Në këto kushte, ajo e ka të pamundur që të kryej shërbimin 24-orësh pranë spitalit dhe të lërë*

<sup>1</sup> Referuar Certifikatës Familjare nr. 000942201, datë 24.02.2021, I.B është kryefamiljare, nënë e dy fëmijëve të mitur.

fëmijët të vetëm, pa asnjë kujdesje dhe për një kohë të gjatë, të mbyllur brenda në shtëpi. Në këto kushte fëmijët nuk mund të ushqehen, qëndrojnë dhe flenë të vetëm dhe mund të dëmtohen si fizikisht por mund të kalojnë dhe shqetësime/stres/frikë duke qëndruar të vetëm dhe pa kujdesin e një të rrituri, në veçanti gjatë orëve të natës. Ankuesja shpjegon se gjatë kohës që është në punë, gjendja e saj shpirtërore dhe emocionale mund të ndikojë në cilësinë e detyrës së saj si mjekë, që mund t'i kushtojë rëndë në jetën dhe shëndetin e pacientëve, për të cilën mund të mbajë dhe përgjegjësi ligjore. Gjatë këtyre viteve ka pasur mirëkuptimin e kolegëve dhe të stafit drejtues të Spitalit Rajonal Fier, të cilët e kanë zëvendësuar shumë herë në kryerjen e këtij shërbimi, por njëkohësisht, ka kryer këtë shërbim 24-orësh, shumë herë, dhe në këto raste ka marrë ndihmën e familjarëve të saj. Por ndihma e familjarëve po bëhet gjithmonë e më e pamundur me kalimin e kohës. Në situatën aktuale të pandemisë Covid-19, prindërit nuk mund të qëndrojnë pranë fëmijëve të saj, por dhe çdo njeri tjetër që mund ta ndihmonte, pasi rrezikojnë infektimin, sepse fëmijët shkojnë në shkollë dhe ajo për shkak të profesionit mund të jetë e infektuar në vendin e punës. Shqetësimin e mësipërm I.B e ka ngritur disa herë në mënyrë verbale pranë Spitalit Rajonal Fier, por dhe me shkrim, në vitin 2018. Në komunikimin me Spitalin Rajonal Fier, I.B ka kërkuar ndryshimin e Kontratës së Punës, për heqjen e detyrimit për kryerjen e shërbimit 24-orësh, në mënyrë që të ushtrojë sa më mirë përgjegjësitë e saj prindërore, dhe për të drejtën e fëmijëve të saj për t'u rritur në mënyrë të shëndetshme. Ankuesja shprehet se, në kushtet kur do jetë e detyruar në mënyrë të vazhdueshme të kryej shërbimin 24-orësh, ajo në mënyrë indirekte do jetë e detyruar që të largohet nga vendi i punës, pasi do ta ketë të pamundur të kryej detyrat e punës përpara interesit më të lartë të fëmijëve të saj. Ky fakt mund ta dëmtoj atë personalisht në ushtrimin e të drejtës për punë, në profesionin si mjekë, ashtu dhe fëmijët e saj të mitur të cilët kanë si burim të vetëm të ardhurash, pagën e saj”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe që Spitali Rajonal Fier të bëjë ndryshimin e pjesshëm të kontratës së punës duke i hequr detyrimin për të kryer shërbimin 24-orësh.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7/1 i LMD-së<sup>2</sup>, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 29, datë 25.02.2021 të shtetases I.B u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 352/1, datë 01.03.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Spitali Rajonal Fier, për ankesën e bërë nga I.B si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
  - Informacion, nëse ka punonjës të tjerë që gjatë 3 viteve të fundit janë përjashtuar nga shërbimi i rojes 24-orësh. Nëse po, kopje të urdhrave dhe të arsyes së përjashtimit.
  - Kopje të Urdhërit nr. 83, datë 12.02.2021 “Për kryerjen e shërbimit të rojes (24 orëshit) në shërbimin e mjekësisë së përgjithshme”.
  - Kopje të Rregullores së Brendshme të Spitalit Rajonal Fier.
  - Kopje të Udhëzimit të Ministrisë së Shëndetësisë nr. 37, datë 10.03.1994 “Për detyrat dhe funksionimin e sektorit të personelit”, të ndryshuar.
  - Kopje të vlerësimeve të punës të I.B për vitet: 2018-2020.
  - Kopje të Kontratës së Punës me mjeken, I.B.

Referuar dokumentit, Lajmërim marrje poste nr: RR611625114AA, datë 03.03.2021 rezulton se shkresa sipërcituar është marrë në dorëzim nga Spitali Rajonal Fier, i cili ka marrë dijëni për shkresën e mësipërme, në kushtet kur dokumenti është nënshkruar nga punonjësja e këtij Institucioni, ashtu dhe nga nëpunësi i shërbimit postar.

---

<sup>2</sup> Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

- Në mungesë të përgjigjes së Spitalit Rajonal Fier, nëpërmjet shkresës me nr. 352/2, datë 06.04.2021, Komisioneri i është drejtuar sërish, përmes një shkrese kujtese për dërgimin e informacionit, duke e njoftuar përsëri që brenda datës 15.04.2021 të paraqesë parashtrimet mbi çështjen në fjalë.

Me shkresën nr. 1648/1, datë 07.04.2021, Spitali Rajonal Fier, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Drejtoria e Spitalit Rajonal Fier, për shkak të kushteve emergjente të krijuara (2 mjekë rezultuan të infektuar me Covid-19, të cilët kishin të detyruar karantinimin dhe duhet të trajtoheshin e kuroheshin), për moscënimin e ofrimit të shërbimit spitalor 24/24, ka nxjerrë Urdhërin nr. 890, datë 12.02.2020, për mbulimin e shërbimit 24 orësh, në të cilin është përfshirë dhe ankuesja, I.B, e cila sipas këtij urdhëri duhet të kryente vetëm 1 (një) ditë shërbim në Klinikën e Mjekësisë së Përgjithshme, me datë 24.02.2021 (zëvendësonte Dr. F.J e sëmurë me Covid-19). Drejtoria e Spitalit Rajonal Fier, nisur nga kushtet familjare të I.B, ka nxjerrë Urdhërin nr. 4837, datë 30.10.2019, duke e përjashtuar nga shërbimet 24 orëshe, shërbime të cilat mbulohen nga kolegët e saj. Nga komunikimi me telefon me I.B, me datë 07.04.2021, ka konfirmuar se nuk është vendosur në grafik për kryerjen e shërbimeve roje për muajt mars-prill”.*

Me e-mail-in datë 12.04.2021 të dërguar nga inspektori i çështjes, ankuesja është njohur me shkresën përgjigje të dërguar nga Spitali Rajonal Fier.

- Nëpërmjet e-mail-it datë 04.05.2021, të dërguar në adresë të inspektorit të çështjes, ankuesja ka kërkuar që të tërhiqet momentalisht nga ankesa e saj, duke theksuar se në kushtet aktuale, ajo nuk figuron në listën e rojeve dhe shpreson që të mos jetë dhe në të ardhmen.

Në nenin 90/3 të Ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* parashikohet se: *“Përfundimi i procedurës administrative: 3. Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.*

Në nenin 94/1 të Ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* parashikohet se: *“Tërheqja e kërkesës.....: 1. Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.*

Komisioneri konstaton se procedura administrative konkrete ka filluar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga I.B, e cila me anë të deklaratës, datë 04.05.2021 është tërhequr nga ankesa.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri çmon se jemi në kushtet e nenit 90/3 dhe 94/1, të Kodit të Procedurave Administrative dhe për rrjedhojë procedura administrative për shqyrtimin e ankesës

duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për shkak se ankuesja është tërhequr nga ankesa.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 3, nenin 33, pika 10 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 29, datë 25.02.2021, paraqitur nga I.B kundër Spitalit Rajonal Fier për shkak se ankuesja është tërhequr nga ankesa.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**